



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:016459

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06353722

Ac.nr.5925/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët, Hunaida Pasuli kryetare e kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Rafet Haxhaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Q. nga fshati V., te cilen me autorizim e perfaqeson A. H. av. nga D., kundër të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.255/20, të datës 29.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.255/20, i datës 29.08.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.255/20, të datës 29.08.2023, ka vendosur si në vijim: **I. APROVOHET** kërkespadija e precizuar e paditësit A.Q. nga fshati V. si e **BAZUAR, OBLIGOHET** e paditura Komuna e Lipjanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit te ia paguaj shumën prej 1.692,00-€, ne emer te kompenzimit per ushqim per perioden 18.04.2017 e deri me date 20.04.2022, me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga data 29.08.2023 e deri te pagesa definitive, si dhe ne shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 238.00€, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dorezimi i aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave materiale, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi, duke i kontestuar në tërësi si të pabazuara pretendimet ankimore, me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës, ndërsa të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 05.02.2020, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, kërkesën e së cilës e ka precizuar me parashtrësën e dt. 13.05.2022, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas përgjigjes në padi nga e paditura dhe pas vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës në bazë të nenit 398 të LPK-së, pa caktuar seancë gjyqësore, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.255/2020, të datës 29.08.2023, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si punëtor teknik në SH.M.U "F. A." në fshatin M., paralelja e ndarë në V., Komuna e L.. Gjykata përmes vërtetimit të lëshuar nga ana e të paditurës për ditët e pranisë në punë, kishte vërtetuar faktin se paditësi prej datës 18.04.2017 e deri me date 20.04.2022 ka qenë prezent në punë për 846 ditë pune, ndërsa e paditura në cilësinë e punëdhënëses, paditësit nuk ia ka kompensuar shpenzimet e ushqimit, përkundër detyrimit që përcaktohet në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë. Nga kjo gjendje faktike, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia ka mbështetje në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, prandaj me aprovimin e kërkesëpadisë e detyroi të paditurën që paditësit në emër të shpenzimeve të ushqimit t'ia paguaj shumën prej nga 2 euro për ditët e realizuara në punë, e në shumën e përgjithshme të gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 2 dhe 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017. Vendimin për kamatën e ka bazuar në nenin 382 par. 2 të LMD-së, Vendimin për shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka bazuar në nenin 452.1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i

përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave neni 182.2 pika n) ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si punëtor teknik ne SH..M.U “F.A.” në fshatin M., paralelja e ndarë në V. Komuna e L. dhe se 8.04.2017 e deri me date 20.04.2022 ka qenë prezent në punë për 846 ditë pune, fakt ky i provuar sipas vërtetimit nr. 1213/1, dt. 20.04.2022. Në prezencë të kësaj gjendje faktike, gjykata ka ardhur në përfundim të drejtë se kërkesëpadia është e bazuar, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit e ka detyruar të paditurën si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar që për 846 ditë të pranisë në punë t’ia paguaj shumën prej nga 2 euro për secilën ditë, gjegjësisht shumën e përgjithshme prej 1,692.00 €.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 90 paragrafin 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragraf 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, të lidhura dhe

nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes të së drejtës për të parashtruar kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë dhe shpërblimit jubilar, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë si dhe shpenzimeve të udhëtimit, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e Apelit, mori parasysh edhe pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar për zbatimin e dispozitave që ndërlidhen me implikimet financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5925/23, me datë 22.10.2024

Kryetarja e kolegjit

Hunaida Pasuli